



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Transaksioni i blerjes së 5% të aksioneve në shoqërinë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA nga Banka Credins SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi se Banka Credins SHA, pjesëmarrëse në shoqërinë Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA me 47.5% të aksioneve, është në procesin e blerjes edhe të 5% të aksioneve të aksionarit tjetër të shoqërisë, Z.Artan Gjergji.

Palët në transaksion:

Pala blerëse: Banka Credins SHA, është një shoqëri aksionare e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila vepron si bankë e nivelit të dytë me objekt veprimtarie; Veprimtaritë bankare dhe financiare.

Pala shitëse: Z.Artan Gjergji, individ.

Shoqëria Target: Regjistri Shqiptar i Titujve Alreg SHA, është një shoqëri e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me objekt veprimtarie; Kryerja e veprimtarisë së regjistrarit të titujve për të gjithë titujt e lejuar sipas ligjit për titujt dhe në përputhje me licencën e dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria do të mbaje regjistrat e titujve, do të organizojë dhe administrojë të dhënat mbi të gjitha llojet e titujve, sipas përcaktimeve dhe kufizimeve të Ligjit për titujt dhe të licencës përkatëse, si dhe do të kryejë emërtimin dhe kodifikimin e titujve sipas praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Shoqëria do të ofrojë shërbimin e regjistrimit të titujve duke bërë të mundur që të sigurohen në çdo kohë të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt e regjistruar, si dhe kufizime të të drejtave të pronësisë mbi to. Shoqëria do të kryejë të gjitha veprimtaritë e regjistrarit të titujve të parashikuara nga Ligji për Titujt dhe aktet nënligjore në zbatim. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e klerimit dhe shlyerjes së titujve si operator i sistemit të shlyerjes së titujve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.